

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“RENT & TRAVEL AZL SHPK”**

Sot, më datë 01.02.2024 (dymijë e njëzet e katër), ortakët themelues:

1. **Z.Aris Çollaku**, shtetas egjiptian, lindur në Egjipt, më 21.10.1969, dhe banues në adresën Rruga “Peti”, Nd.9, H.1, Ap.13, Sauk, Fark, 1044 Tiranë, identifikuar me ID Nr.G91021077U.
2. **Z. Eglantin Alushaj**, shtetas shqiptar, lindur në Fier, më 03.09.1974 dhe banues në adresën Rruga: “Dritan Hoxha”, pallati MC Inerte, hyrja 3, kati 5, Ap.14 Tiranë identifikuar me ID Nr. H40903034O.
3. **Z. Zamir Çollaku**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 20.07.1966, dhe banues në adresën Rr.Kavajës Kompleksi Delijorgji, Objekti CC1, Ap.33, Shkalla A , identifikuar me ID Nr. G60720069R.

Vendosën:

Themelimin e shoqërisë tregtare “**RENT & TRAVEL AZL SHPK**” me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqërinë Tregtare “**RENT & TRAVEL AZL SHPK**” është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**RENT & TRAVEL AZL SHPK**”.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë është shërbim Transporti brenda dhe jashtë vendi. Dhënia e automjeteve me qera (makina, furgon, mjete motorike lundruese, etj) . Shitblerjen e tyre.

Agjensi Turistike. Shërbime për udhëtime, detare e tokësore, shërbime utilitare, etj.

Gjithashtu, shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet tjetër qe lidhet direkt ose indirekt, me objektivin e mësipërm, të tilla si por pa u kufizuar, aktivitet tregtar, financiar, qiraje, që mund te konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm ne mënyrë qe te realizohet objekti i shoqërisë.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës, në adresën: Rruga e Aeroportit “Nënë Tereza”, Ndërtesa 1- katëshe, Zona kadastrale 3183, Nr. Pasurie 41/12, Tiranë.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është kontributi i ortakëve themelues, në vlerën 3000.000 (tre milionë) Lekë. Kapitali themeltar të shoqërisë zotërohet nga ortakët si vijon:

1. **Z.Aris Çollaku** zotërues i një kuote që përfaqëson 25 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë në vlerën 750.000;

2. **Z. Eglantin Alushaj**, zotërues i një kuote që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë në vlerën 1.500.000;

3. **Z.Zamir Çollaku**, zotërues i një kuote që përfaqëson 25% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë në vlerën 750.000;

Kapitali themeltar shlyhet pasi regjistrimit të shoqërisë sipas kontributit në të holla ose në natyrë që ortakët do të vlerësojnë sipas ligjit.

NENI 5

Të drejtat dhe detyrat e ortakëve

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Pasuritë e shoqërisë mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng e hipotekë me miratimin e asamblesë së ortakëve.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/ortaku i vetëm – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga një Administratorë e cilat zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administrator i Shoqërisë do të jetë:

3. **Z. Zamir Çollaku**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 20.07.1966, dhe banues në adresën Rr.Kavajës Kompleksi Delijorgji, Objekti CC1, Ap.33, Shkalla A identifikuar me ID Nr. G60720069R.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët/u themelues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12


Dispozitat përfundimtare

Akti i Themelimi hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesve, të cilët, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e nënshkruan pa vërejtje.


ORTAKËT E SHOQËRISË

“RENT & TRAVEL AZL SHPK”

Z. Aris Çollaku



Z. Eglantin Alushaj



Z. Zamir Çollaku

